



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site:www.klsh.org.al

Nr.374/5Prot.

Tiranë, më 15.12.2017

V E N D I M

Nr.170, Datë 15.12.2017

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË, "MBI AUDITIMIN E
FINANCIMIT TE PROJEKTIT TË BULEVARDIT VERIOR TË TIRANËS DHE
REHABILITIMI I LUMIT TË TIRANËS", PËR PERIU DHËN PREJ FILLIMIT DERI
NE 30.09.2017.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Tiranë, Drejtorinë e Menaxhimit të Investimeve të Huaja, për projektin me huanë e Fondit për Zhvillim Abu Dhabi, me objekt "Ndërtimi i bulevardit verior të Tiranës dhe të rehabilitimit të lumit të Tiranës", rezultoi se në përgjithësi është zbatuar Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi, e ratifikuar me Aktin Normativ nr. 3, datë 03.05.2013, të Këshillit të Ministrave, i miratuar me ligjin nr. 150/2013, datë 06.05.2013. Nga auditimi është arritur në opinionin se Bashkia Tiranë, Drejtoria e Menaxhimit të Financimeve të Huaja, duhet të marrë masa në drejtim të menaxhimit më me efektivitet dhe në kohë të Kontratave, rritjes në një nivel më të lartë të përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit menaxherial, duke mos shkaktuar rritje të cmimit të kontratës dhe efekte negative për shkak të ndryshimit të planit urbanistik.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit IT^{se} dhe Financimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi auditimin financimit te projektit të bulevardit verior të Tiranës dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës", sipas programit të auditimit nr.374/2, datë 07.09.2017, për veprimtarinë prej fillimit të projektit deri më datën 30.09.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit, në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjen me huadhënësit, sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 03.05.2013 të Këshillit të Ministrave, i miratuar me ligjin nr. 150/2013, datë 06.05.2013, për “Miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit nr. 3, datë 03.0.2013, të Këshillit të Ministrave “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi dhe Marrëveshjes së Nën-Huasë midis Ministrisë së Financave dhe Bashkisë së Tiranës, në lidhje me kontratën e zbatimit të punimeve të ndërtimit për projektin “Punime Rehabilitimi në Lumin e Tiranës dhe brigjet e tij dhe të gjitha punimet civile dhe ndërtimore përkatëse”, për komponentin “Higjienizim e thellë dhe kanalizimin e ujërave të zeza”, gjatë inspektimit në terren u konstatua se në zonën nga km 5+640 km në km 5+740 nga ana e Kamzës kolektori kryesor i ujravë të zeza nuk është ndërtuar ende. Objektivi për higjienizim e thellë dhe kanalizimin e ujërave të zeza të shpërndara përgjatë lumit deri në periudhën e auditimit ku kanë përfunduar mbi 84 % të punimeve, nuk është përmbyshur tërësisht. Kjo nyje konsiderohet si në një pikë me ndotje të lartë për banoret e zonës. Gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se kontraktori e ka të pamundur ndërhyrjen në këtë zonë për shkak të problemeve të shpronësimeve. Deri në periudhën e auditimit Kontraktori dhe PIU kanë korespondencë me Bashkinë e Kamzës e cila është përgjegjëse në lidhje me çështjen e shpronësimeve për këtë zonë, por ende nuk i është dhënë zgjidhje. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.18-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi

Bashkia Tiranë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Financimeve të Huaja, të marrë masa urgjente duke ndjekur të gjitha rrugët institucionale e ligjore për zhblokimin e situatës së shpronësimeve në lidhje me Bashkinë Kamëz, me qëllim vazhdimin normal të punimeve.

Menjëherë.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit, sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 03.05.2013 të Këshillit të Ministrave, i miratuar me ligjin nr. 150/2013, datë 06.05.2013, si dhe në kontratën e lidhur e grafikun e punimeve, në lidhje me progresin e punimeve të kontratës “Ndërtimi i bulevardit Verior të Tiranës dhe punivet civile përkatëse”, kur kanë kaluar 48 muaj nga data e fillimit të punimeve, pra 87% e kohës së përfundimit të punimeve rezulton të jenë realizuar vetëm 57.9 % e punimeve, mbetet dhe 42.08% e punimeve për t`u përfunduar në 7 muajt e ardhshëm. Nga analiza e grafikeve të përqindjes së kohës së kaluar në raport me përqindjen e punimeve të kryera, është i pamundur realizimi në kohë i punimeve të mbetura për aq kohe sa trendi i progresit mbetet i njëjtë. Kjo situatë e ardhur nga vonesa edhe në shpronësime, mund të sjellë vonesa të mundshme të përfundimit të projektit si dhe mbart një risk të lartë për kosto shtesë për projektin. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.18-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi

Bashkia Tiranë, Drejtoria e Menaxhimit të Financimeve të Huaja, të marrë masa që kontraktori të rrisë kapacitetet në mënyre që të arrijë përfundimi në kohë i projektit si dhe të marrë masa për miratimin e një grafiku shtesë punimesh në rastin e mospërfundimit në afat të punimeve.

Menjëherë.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i menaxhimit financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar, rezultuan vonesa në financimin e punimeve të kontratës. Më datë 08.08.2013 marrveshja e huasë është deklaruar efektive dhe fuqiptotë nga ADFD. Më datë **07.10.2013**, Bashkia Tiranë më anë të shkresës nr.9973 ka njoftuar Ministrinë e Financave dhe ADFD për punonjesit e autorizuar për kryerjen e veprimeve. Në Janar 2014 ka përfunduar prokurimi i të tre komponenteve sipas rregullave ndërkombëtare të vendosura nga ADFD dhe marrveshjes së financimit. Bashkia Tiranë ka dorëzuar një kopje të kontratave të ADFD dhe ka filluar punën në terren. Ndërkohë që pavarësisht kërkesave të Bashkisë Tiranë drejtuar Ministrisë së Financave që nga data 07.03.2013 dhe më e fundit ajo me nr. 10749/1, datë 11.08.2015, për përcaktimin e specimeneve të firmave të autorizuar për punonjësit e autorizuar për kryerjen e veprimeve, dhënia e këtyre specimeve është bërë e mundur në tetor 2015. **Për rrjedhojë financimi i kredisë si rezultat i mos miratimit nga ana e Ministrisë së Financave që nga data 07.03.2013 ka filluar 1,5 vjet më vonë, kohë kur u miratuan nga ana e kësaj Ministrie specimenet e firmave të autorizuar. Ky veprim është në kundërshtim me Aktin normativ nr. 3, datë 03.05.2013,** “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për zhvillim Abu Dhabi, për financimin e projektit të Bulevardit Verior dhe të rehabilitimit të Lumit të Tiranës”, si dhe ligjit nr. 149/2015, “Për ratifikimin e dokumentit ndryshues të marrëveshjes së huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi, për financimin e projektit të Bulevardit Verior dhe të rehabilitimit të Lumit të Tiranës”, e cila ka sjellë kosto shtesë me shtesat e kontratës të konsulentit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 29-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi

Bashkia Tiranë, Drejtoria e Menaxhimit të Financimeve të Huaja, të marrë masa duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë e institucional, që në të ardhmen të koordinojë punën me institucione të tjera për rregullshmërinë e veprimeve në lidhje me fillimin dhe ecurinë normale të projekteve.

Në vijimësi.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i financimit të tre kontratave të lidhura, “Zgjatimi i bulevardit të Tiranës”, “Rehabilitimi i lumit të Tiranës”, “Asistenca teknike dhe mbikqyrja e punimeve për Bulevardin verior të Tiranës dhe punime rehabilituese të lumit të Tiranës”, rezulton se deri më datë 10.10.2017 është financuar 56.7% e shumës së kredisë së celur, ku për dy vitet e para 2013 e 2014 vetëm 8 %, e cila përbëhet kryesisht nga pagesa e paradhënies në avancë. Moszhvillimi i punimeve dhe likuidimeve është si pasojë e mos miratimit të specimeneve të firmave nga ana e Ministrisë së Financave, me pasojë shtyrjen e afatit të punimeve, ose mosbërjen efektive të objektit dhe e shoqëruar me kosto shtese (shtesat e

kontratës së konsulentit në shumën **974,719 Euro**. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 29-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi

Bashkia Tiranë, Drejtoria e Menaxhimit të Financimeve të Huaja, të marrë masa duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë e institucional, që në të ardhmen të koordinojë punën me institucione të tjera për rregullshmërinë e veprimeve në lidhje me fillimin dhe ecurinë normale të projekteve.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga inspektimi në terren i zbatimit të kontratës “Ndërtimi i bulevardit Verior të Tiranës dhe punimet civile përkatëse” u konstatua se progresi i punimeve në vepër paraqitet 49.7 %. Punimet për t`u realizuar 50.3 % në raport me kohën 28.4 %, flasin për një ritëm të ngadaltë të realizimit të punimeve, bazuar në kontratën e lidhur midis palëve. Objektivi për ndërtimin e bulevardit verior të Tiranës deri në periudhën e auditimit në datë 31.10.2017, ku kanë përfunduar 49.7% të punimeve nuk është përmbushur tërësisht. Problematika në mos realizimin e objektivit lidhet me procesin e shpronësimeve në segmentin (km.1+250 - km. 1+350) ku ende nuk ka zotërim të plotë të kantierit në krahun e majtë të limitit të projektit dhe në segmentin km 1+250- Km 1+350. Në segmentin (km. 1+350 - km. 1+600) nuk ka akses të kantierit, gjë që përben një problem madhor për shpronësimin. Nuk është bërë shpronësimi për 60 persona të përfshirë në planin e shpronësimeve për t`u shembur. Kontraktori e ka të pamundur ndërhyrjen në këto segmente për shkak të problemeve të shpronësimeve. Duke u gjendur para kësaj situatë është e pamundur ndërhyrja në segmentet e sipërcituara nga ana e kontraktorit, i cili i është drejtuar në mënyrë shpresore PIU-t pranë Bashkinë së Tiranës. Për këto veprime mban përgjegjësi PIU dhe bashkia Tiranë të cilat sipas marrëveshjes duhet të sigurojnë drejtat e pronësisë përpara zbatimit të projektit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 41 -56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi

Bashkia e Tiranës si përfituesi kryesor i këtij investimi, të bashkërendojë punën me Ministrinë e Financës, për përsheptimin procedurave të shpronësimit për 60 personat tashmë të përfshirë në planin e shpronësimit si dhe pronat e tjera përgjatë gjurmës së Bulevardit Verior të Tiranës.

Menjëherë.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës “Ndërtimi i bulevardit Verior të Tiranës dhe punimet civile përkatëse” u konstatua se mbas urdhër ndryshimeve nga mos harmonizimi i punës midis kontraktorit, Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve të Huaja dhe Konsulentit, kanë llogaritur dhe pasqyruar gabim vlerës së kontratës, si pasojë e gabimeve në kolonën “Revised BOQ as per Addendum nr. 2 and V.O Nr. 2 and V.O Nr. 3” paraqitet shumën totale në vlerën 28,771,669.12 Euro dhe jo shumën 29,783,627 Euro pranuar në rishikimin e vlerës së kontratës pas vlerësimit të V.O. Nr. 3. Për sa më sipër veprimet janë bërë gabim duke ulur me vlerën **11,957.88 Euro** shumën e kontratës. Mospërputhja e konstatuar duhet të bëhet objekt i modifikimit të IPC-ve në vazhdimësi të zbatimit të projektit. Kjo parregullsi u konstatua bazuar në kontratë dhe në FIDIC, kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet parregullsi. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 41 -56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi

Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve të Huaja në Bashkinë Tiranë, në bashkëpunim me shoqërinë zbatuese të punimeve “C.” Safat, Kuwait si dhe Supervizorin e punimeve, të harmonizojnë punën që për rastin konkret dhe në vazhdimësi të bëjë korrigjimet dhe modifikimet për volumet dhe vlerat përkatëse të konstatuara në disbursimet në vijim, deri në përfundimin e kontratës.

Menjëherë.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës “Ndërtimi i bulevardit Verior të Tiranës dhe punivet civile përkatëse” rezultuan gabime në llogaritje në analiza zërash të rinj.

Në përcaktimin e çmimit të bazamentit të një shtylle, me analizë çmimi (Cost break down, New items) u konstatua se janë bërë gabime në llogaritje. Nga llogaritja e bërë nga grupi i auditimit për zërin C.01.02 (Excavation) dhe duke zbritur volumin që ze zëri F.01.05 (Corrugate Pipe DN 200) dhe volumin e zërit G.02.06 (Plastic mandole) rezulton se çmimi për njësi për zërin G.NP.03 (Foundation Electrical Pole) është 189.86 Euro dhe jo 208.56 Euro, kjo me pasoj efekt negativ financiar. Kjo parregullsi u konstatua bazuar në kontratë dhe në FIDIC, kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet parregullsi. Zëri është paguar në shumën 8258 Euro më tepër. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 41 -56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi

Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve të Huaja në Bashkinë Tiranë, në bashkëpunim me shoqërinë zbatuese të punimeve “C.” Safat, Kuwait si dhe konsulentin e punimeve, të harmonizojnë punën që për rastin konkret dhe në vazhdimësi të bëjë korrigjimet dhe modifikimet për volumet dhe vlerat përkatëse të konstatuara në disbursimet në vijim, deri në përfundimin e kontratës si dhe të korigjojë pagesën më tepër në shumën 8,258 Euro.

Menjëherë.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së punimeve të ndërtimit për projektin “Punime Rehabilitimi në Lumin e Tiranës dhe brigjet e tij dhe të gjitha punimet civile dhe ndërtimore përkatëse”, u konstatua dëmtime të vogla nga banoret e zonës, gjatë gjithë shtrirjes së lumit, por janë vërejtur dhe djegje e dëmtime më të mëdha në afërsi të kilometrit 4+500 dhe 6+600. Prishja dhe djegja ka sjellë mos efektivitetin e masës mbrojtëse dhe mosparandalimin e erozionit *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.56 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi

Bashkia Tiranë, Drejtoria e Menaxhimit të Financimeve të Huaja, në bashkëpunim me kontraktorin të marrë masa për eliminimin e dëmtimeve gjatë gjithë shtrirjes së lumit si dhe të sensibilizojë banorët e zonës për rrezikun e prishjes së punimeve të kryera.

Menjëherë.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së punimeve të ndërtimit për projektin “Punime Rehabilitimi në Lumin e Tiranës dhe brigjet e tij dhe të gjitha punimet civile dhe ndërtimore përkatëse”, u vu re prishje dhe dëmtimi rrjetave të gabioneve, nga banoret e zonës, ku shihen prerje dhe heqje e rrjetave të hekurit dhe prishje e strukturës dhe e funksionit mbajtës së tyre. Riparime të gabioneve janë të nevojshme në këto vende si dhe në km 3+740 ana

e majtë, km 0+580 ana e djathtë, 2+300 ana e djathtë. Gjithashtu janë vreytur zona ku ka ndodhur prishje dhe thyerje e betoneve të pritave me qëllim nxjerrjen dhe vjedhjen e hekurit. Prishja e këtij lloji të mbrojtjes së skarpatave sjell mosefektivitetin e masës mbrojtëse dhe mosparandalimin e erozionit (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr.56 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi

Bashkia Tiranë, Drejtoria e Menaxhimit të Financimeve të Huaja, në bashkëpunim me kontraktorin të marrë masa për eliminimin e dëmtimeve të rrjetave të gabioneve, ku janë konstatuar prerje dhe heqje e rrjetave të hekurit dhe prishje e strukturës dhe e funksionit mbajtës së tyre. si dhe të sensibilizojë banorët e zonës për rrezikun e prishjes së punimeve të kryera.

Menjëherë.

10. Gjetje nga auditimi: Gjatë inspektimit në terren te kontrates se punimeve të ndërtimit për projektin “Punime Rehabilitimi në Lumin e Tiranës dhe brigjet e tij dhe të gjitha punimet civile dhe ndërtimore përkatëse”, u konstatua se fenomeni i hedhjes së mbeturinave nga banoret e zonës apo të tjerë, mbi bankina dhe shtrat të lumit është shume i përhapur. Hedhja e mbeturinave sidomos në vendet e hapura, të cilat në fazën në vazhdim të projektit janë pjesë e zonave rekreative dhe të gjelberta, përben problem dhe do të kërkojë punime shtesë në të ardhmen për pastrimin e tyre (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 56 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi

Bashkia Tiranë, Drejtoria e Menaxhimit të Financimeve të Huaja, të marrë masa administrative ndaj personave bazuar në aktet ligjore në fuqi, kundër fenomenit të hedhjes së mbeturinave mbi bankina dhe shtrat të lumit.

Menjëherë.

B MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga inspektimit në terren të zbatimit të punimeve civile të kontratës u konstatua se: si pasojë e disbursimit të disa zërave të punimeve civile të pa azhurnuara dhe të pamodifikuara nga pasqyrimet në dokumentet teknike të zbatimit dhe kryesisht në: Interim Payment Certificate (IPC) dhe nga Measurement Sheet Draëing nga disbursimi IPC Nr. 2 deri në disbursimin IPC Nr. 10, **me efekt negativ financiar në shumë 162,630 Euro**, bazuar ne kontratë dhe në FIDIC, kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet parregullsi. Sa më sipër ka ardhur si pasojë e mos azhurnimit me saktësi i zërave të punimeve që pësojnë ndryshime dhe reflektimi i vlerave përkatësi me saktësi në Interim Payment Certificate (IPC-të) në Measurement Sheet Drawing dhe në Measurement Sheet. (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 41-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi

Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve të Huaja në Bashkinë Tiranë, t'i kërkojë shoqërisë “ C.” Safat, Kuwait, që për rastin konkret dhe në vazhdimësi të bëjë korrigjimet dhe modifikimet për volumet dhe vlerat përkatëse të konstatuara në disbursimet në vijim, deri në përfundimin e kontratës.

Menjëherë.

C. MASA DISIPLINORE

Nuk rekomandojmë masa disiplinore për arësye se shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar nuk përbëjnë bazë materialiteti për dhënie mase disiplinore si dhe konstatimet janë të korigjueshme pasi projekti dhe kontratat e punëve civile janë në zbatim e sipër.

Marrja ne konsiderate e rekomandimeve do te konsiderohet si instrument i eliminimit te defekteve negative financiare te evidentuara, te cilat do te jene objekt i auditimeve ne te ardhmen.

-Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të IT dhe Projekteve të Huaja dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R